



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Fushë Kosovë shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët 2
Koeficienti/Paga	8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	25/03/2022
Afati për aplikim	09/04/2022 - 16/04/2022
Institucioni	Komuna Fushë Kosovë
Departamenti	Drejtoria për Shëndetësi dhe MS
Divizioni	
Vendi i punës	Qendra për Punë Sociale
Nr. i Referencës	RN00008701
Kodi	RPC0002477



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Udhëheqë punën e përgjithshme të Sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin
- Menaxhon Stafin e sektorit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, si dhe ofron udhëzime dhe monitorim të stafit
- Në bashkëpunim me Drejtorin, bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllime të arritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës
- Siguron Shërbime Sociale adekuate në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindër, birësimin, strehimin familjar, kujdestarinë dhe strehimin e përkohshëm familjar
- Ndërmerr të gjitha veprimet në përputhje me procedurat ligjore për mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuent si dhe mbrojtje të moshuarve
- Siguron shqyrtimin e rasteve me abuzim dhe lënien pa kujdes të fëmijëve, dhunës në familje dhe raste të trafikimit dhe ndërmerr masa dhe veprime adekuate
- Kontribuon në përmasimin e mërdhezeve bashkëshortore dhe familjare si dhe propozon për besim të fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve
- Kontakton drejtpërdrejt me palët /klientët në nevojë për të vlerësuar nevojat e tyre fillestare për shërbime dhe bën kategorizimin e shërbimeve si dhe bashkëpunimin me institucione përkatëse lidhur me shërbimet sociale
- Siguron zbatimin e politikave dhe legjislacionit lidhur me skemat për ndihmë sociale për personat me nevojë
- Zhvillon programe dhe projekte dhe përcakton prioritetet për raste sociale, zgjidhje e çështjes së strehimit
- Siguron shqyrtimin e aplikacioneve për ndihmat sociale në kohën e duhur dhe marrjen e vendimeve në baza të kritereve të përcaktuara me legjislacion në fuqi
- Përgatit Informata për sqarim të kritereve dhe procedurave për plotësimin e aplikacioneve për përfitim nga skema e ndihmave sociale
- Bashkëpunon me sektorin qeveritar dhe joqeveritar
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tijë dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave në përputhje me standarde të kërkuara

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, Punëtor Social, Sociolog, Pedagog, Psikolog
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjislationit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon sektorin;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative ;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të sektorit.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende
- Vërtetim që nuk je në hetime nga Gjykata

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 23/04/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 16.05.2022 Salla e Kuvendit Komunal kati I ora 13

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikë operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njohimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen